



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipal Kaçanik

01Nr. 400/01-27193/23
Kaçanik, 31.10.2023

Në bazë të nenit 40.2 (b) të Ligjit Nr.03/L-040 – Për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/4 Qershor 2008) të Ligjit Nr.03/L-048 –Për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 27/03 Qershor 2008) të Ligjit Rr.03/L-221-Për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.03/L-048-Për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, të nenit 15 dhe 16 të Ligjit Nr. 08/L-193 – Mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2023 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.38/30 Dhjetor 2022), të nenit 61 të Statutit të Komunës, të Propozim Vendimit të Kryetarit të Komunës 01Nr. 400/01-27193/23 të datës 17.10.2023, Kuvendi i Komunës Kaçanik në mbledhjen e mbajtur me 31 tetor 2023, mori këtë:

**VENDIM PËR TRANSFERIN E MJETEVE BUXHETORE
SIPAS BUXHETIT TË VITIT 2023**

1. Me këtë vendim, bëhet Transferi i mjeteve buxhetore sipas buxhetit të vitit 2023, si vijon:

1.1. **Transferet e mjeteve nga kategoria e Shpenzimeve Komunale (fondi 10):**

Nga nën-programi: Infrastruktura rrugore, shuma prej 10,000.00€;

1.2. **Transferet e mjeteve nga kategoria e Subvencioneve dhe Transfereve (fondi 10):**

Nga nën-programi: Infrastruktura rrugore, shuma prej 8,500.00€.

2. Mjetet e përcaktuara si në paragrafët e pikës 1 të këtij vendimi, transferohen në kategorinë e shpenzimeve mallra dhe shërbime (fondi 10): Në nën programin: Infrastruktura rrugore, shuma prej 18,500.00€

3. Pjesë përbërëse e këtij Vendimi janë Formularet standard nga MFPT, të plotësuara me shumatat e lëvizura sipas Nën-Programeve buxhetore dhe kodeve ekonomike të shpenzimeve.

4. Për realizimin e këtij Vendimi, obligohet Drejtoria e Buxhetit dhe Financave, e cila drejtori të njejtin vendim do ta zbaton në Ministrinë e Financave Transfereve dhe Punës, respektivisht në Departamentin e Buxhetit dhe Departamentin e Thesarit.

5. Ky Vendim hyn në fuqi sipas nenit 17 të Rregullores (MAPL) Nr.01/2017- për procedurën e hartimit dhe publikimin e akteve të komunës.

Me këtë Vendim njoftohen:

1. Kryetari i Komunës;
2. Drejtoria për Buxhet dhe Financa (përmes kësaj drejtorie njoftohen organet tjera relevante);
3. Arkivi.



Kryesuesi i Kuvendi
Kemal Murseli